

Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza” (QSUNT), është Institucion Shëndetësor Publik Kombëtar në shërbim të shëndetit të popullit, të cilit i siguron shërbim shëndetësor parandalues, diagnostikues dhe kurues sipas ligjeve në fuqi, i cili ka në fokus të aktivitetit të tij mbrojtjen e jetës, shëndetit fizik dhe mendor të pacientit dhe lehtësimin e vuajtjeve të tij, duke i ofruar një shërbim shëndetësor sa më cilësor dhe dinjitoz.

Me anë të kësaj thirrje QSUNT dëshiron të kërkojë vëmendjen e publikut lidhur me mundësinë për të kontribuar për hartimin e një raporti të ekspertizës për mbrojtjen dhe sigurinë nga rrezatimi jonizues për bunkerin ku është instaluar akseleratori linear, në përputhje me udhëzimin e miratuar nga KMR nr. 72/21, datë 17.08.2021 “Për përgatitjen e raportit të ekspertizës për mbrojtjen dhe sigurinë nga rrezatimet jonizuese”, nga një ekspert i licencuar për mbrojtjen dhe sigurinë nga rrezatimi i njohur nga Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet

Kjo do të mundësonte përmbushjen e kërkesave rregullatore në një afat sa më të shkurtër dhe garantimin e vijimit të aktivitetit në përputhje me standardet e sigurisë radiologjike.

QENDRA SPITALORE UNIVERSITARE “NËNË TEREZA”